



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Komuna Drenas

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Drejtorati për Zhvillim Ekonomik

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Thirrje publike për subvencionim me mjete financiare për NMVM

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, dhe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve prodhuese, shpallim thirrje të hapur për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për blerjen e makinerisë prodhues.

MTI-KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet sipas kategorive të tyre, si në vijim:

- Për ndërmarrjet mikro (të punësuar 1 deri 9 punëtor) vlera totale e granteve do të jetë 360,000.00 EUR. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje mikro është deri në 75% e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare deri në 20,000.00 EUR;
- Për ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri 49 punëtor) vlera totale e granteve do të jetë 240,000.00 EUR. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e vogël është deri në 50% e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare deri në 30,000.00 EUR;
- Për ndërmarrjet e mesme (të punësuar 50 deri 249 punëtor) vlera totale e granteve do të jetë 100,000.00 EUR. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e mesme është deri në 50 % e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare deri në 50,000.00 EUR.

Lista e të punësuarve të dëshmohet nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2018. Në bazë të së cilës listë do të kategorizohet si ndërmarrje (mikro, e vogël dhe e mesme).

Aplikuesi i cili aplikon për subvencione dhe transfere në Ministri, duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës.

1. Për të aplikuar duhet plotësuar Aplikacionin (*shkarko në web*) më të dhënat bazike të subjektit aplikues dhe duhet të dorëzoj dokumentacionin sipas UA (MTI) 01/2018, si në vijim:
 - 1.1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. Certifikatën e numrit fiskale (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë);
 - 1.3. Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK;
 - 1.4. Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi;

- 1.5. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore – kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë;
- 1.6. Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovë;
- 1.7. Gjendjen e xhirollogarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit. Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme;
- 1.8. Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare si dhe planin kohor të realizimit të projektit dhe strukturën organizative të aplikuesit;
- 1.9. Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitet, (e dëshmuar me deklaratën nën betim);
- 1.10. Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MTI për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratën nën betim);

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik njofton të gjitha bizneset e interesuara se sesioni informues për subvencione që ofrohen nga MTI-ja me mjete financiare për NMVM do të mbahet me datën 07.03.2019 ditë e enjte në objektin e komunës- Salla e Kuvendit në ora 13:00.